

SHKOLLA E MESME “SKËNDERBEU” NË KAÇANIK GJATË VITEVE  
1990-1999, FAKTE DHE DËSHMI  
TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE  
NGA:  
BARDHYL HOXHA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË

DHJETOR, 2022

## REZYME

### SHKOLLA E MESME “SKËNDERBEU” NË KAÇANIK GJATË VITEVE 1990-1999, FAKTE DHE DËSHMI

Mentor: Prof. Asoc. Dr Nuri Bexheti

Qëllimi i kësaj teme është hulumtimi i të dhënave dhe fakteve, përmes të cilave jam munduar të nxjerr në dritë punën, sakrificën dhe sfidat e arsimit shqip e veçmas në rastin tonë, atij kaçanikas. Për të realizuar këtë hulumtim kam përdorur këto metoda: Metoda e analizës teorike, Metoda përshkruese (deskriptive), Metoda historike.

Hulumtimin e burimeve, për punimin e kësaj teme e kam realizuar në Kaçanik, në Arkivin Komunal të Kaçanikut, Arkivin i gjimnazit „Skënderbeu”, Arkivat personal të atyre që kontribuan për arsimin e të rinjve kaçanikas si dhe intervistat me ish-nxënës, ish-mësimdhënës dhe ish- drejtorët e gjimnazit të viteve 1990-1999.

Ky punim përbëhet nga: pesë kapituj kryesor, të cilët në vete përmbajnë edhe njëzet e një nënkapituj, konkluzione, dokumente e fotografi dhe në fund janë burimet dhe literatura që është përdorur për realizimin e këtij punimi shkencor.

**Kapitulli i parë mban titullin: Historiku i zhvillimit të arsimit në Kaçanik**, ku shpjegohen shkurtimisht, të dhënat për zhvillimin e arsimit në këtë trevë duke filluar nga periudha osmane, gjysma e dytë e shek.XVI. Kapitulli në fjalë në vete përfshin të dhënat për ekzistimin e shkollave dhe veprimtarin e tyre në komunën e Kaçanikut në periudhat kohore në mes dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kapitulli trajton edhe qëndrimin e intelektualëve kaçanikas, përpjekjet dhe sfidat e tyre për zhvillimin e arsimit në këtë trevë.

**Kapitulli i dytë mbanë titullin: Fillet e arsimit të mesëm në komunën e Kaçanikut.** Në këtë kapitull analizohet situata shoqërore, ekonomike dhe politike në Kaçanik gjatë viteve të 70-ta, të shek. XX, me një theks të veçantë për fillimin e arsimit të mesëm në këtë komunë. Këmbëngulësia e intelektualëve kaçanikas e dëshmuar përmes procesverbaleve nga mbledhjet ku trajtohej hapja e dy paraleleve të gjimnazit. Kapitulli trajton rritjen dhe zhvillimin e arsimit të mesëm në këtë komunë ndër vite. Të gjitha këto të arritura janë të

dokumentuara përmes dokumentacionit arkivor të hulumtuar, shtypit të kohës dhe intervistat me individ që ishin pjesë e zhvillimeve të kohës.

**Kapitulli i tretë mban titullin: Dhuna shtetërore serbe në arsim dhe largimi nga objektet shkollore.** Në këtë kapitull trajtohen rrethanat shoqërore, ekonomike dhe politike të viteve 1990-1999. Një theks i veçantë vendoset mbi organizimin e mësimit paralel në këtë komunë. Në mënyrë të hollësishme trajtohet largimi nga objektet shkollore dhe gjetjes së formave për vazhdimin e mësimit në kushte ekzistuese.

**Kapitulli i katërt mban titullin: Organizimi i punës së mësimdhënësve në shtëpi-shkolla.** Në këtë kapitull bëhet fjalë për formën e organizimit të punës së mësimdhënësve të Shkollës së Mesme “Skënderbeu” në Kaçanik. Përmes intervistave me ish- nxënës dhe ish-mësimdhënës janë pasqyruar angazhimet dhe puna e bërë me shumë sakrifica dhe me vullnet të madh për të mbajtur gjallë arsimin. Kapitulli trajton organizimin e mësimit nëpër shtëpi-shkolla, si në Kaçanik, në fshatin Kaçanik të Vjetër, në fshatin Doganaj dhe Han të Elezit. Në veçanti shtjellohet përmes dokumentacionit pedagogjik organizimi i mësimit në këtë gjimnaz. Kapitulli trajton rrethanat që ndikuan në krijimin e Këshillit të Financimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tij në këtë komunë. Trajtohet edhe gjendja sociale dhe ekonomike e mësimdhënësve.

**Kapitulli i pestë mban titullin: Sistemi i organizimit të mësimit në gjimnazin „Skënderbeu” në Kaçanik gjatë viteve 1990 – 1999.** Ata të cilët patën guximin dhe udhëhoqën shkollën e mesme “Skënderbeu” gjatë okupimit klasik 1990-1999. Kapitulli vazhdon me përshkrimin e gjendjes sociale dhe ekonomike të mësimdhënësve kryefamiljarë, si dhe me përshkrimin e punës së Këshillit Komunal të Financimit, institucion që kujdesej për pagat e mësimdhënësve. Kapitulli përfundon me një përmbledhje të shkurtër të shkëputura nga intervistat me ish nxënës dhe ish-mësimdhënës të viteve 1990-1999 të kësaj shkolle.

Përkundër kësaj pune të bërë, ka vend dhe hapësirë që edhe më tej të bëhen hulumtime rreth kësaj periudhe të vështirë, por plot lavdi dhe krenari për arsimin shqip.

Me respekt,

Bardhyl Hoxha